



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2020:905130  
Datë: 17.08.2021  
Numri i dokumentit: 02092280

Ac.nr.1474/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi, kryetar i kolegjit, Rustem Thaqi dhe Zenel Leku, anëtar të kolegjit, me zyrtaren ligjore Biondina Zeneli, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a. me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim Fitnete Svarça, kundër të paditurit S.B. nga Prishtina lagja ... .. bl... BI, për pagesën e borxhit për shpenzime të impulseve të telefonit fiks, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2251/11, i datës 11.01.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.08.2021, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurit S.B. nga Prishtina lagja ... .. bl. BI, ndërsa Gjykatës Themelore në Prishtinë –Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2251/11, i datës 11.01.2016, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.2251/11, i datës 11.01.2016, në dispozitiv të aktgjykimit e ka aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a. me seli në Prishtinë dhe është detyruar i padituri S. B. nga Prishtina, që paditëses në emër të borxhit për impulset telefonike të shpenzuara nga telefoni

fiks nr. ...., për periudhën kontestuese dhe atë për muajt 1,2,3,4,5,6,7,8 të vitit 2008 t'ia paguajë shumën prej 151.93 € me kamatë siç e paguajnë bankat vendore për deponimet pa destinim të caktuar në kohëzgjatje më shumë se një vit nga dita e marrjes së këtij aktgjykimit e deri në pagesën definitive, si dhe shumën prej 30.00 € në emër të shpenzimeve procedurale, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbartimit ligjor.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë i padituri duke mos i specifikuar rrethanat për të cilat e atakon aktgjykimin e shkallës së parë, me prpozom që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës kanë paraqitur pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë, propozim për përmbartim kundër të paditurit me datë 13.11.2009.

Gjykata Komunale në Prishtinë me konkluzionin E.Da.nr.4105/2008, i datës 22.08.2011e ka vënë jashtë fuqie aktvendimin për përmbartim dhe ka abroguar të gjitha veprimet e ndërmarra, ashtu që propozimi i kreditorit është konsideruar si padi.

Gjykata Themelore në Prishtinë pas mbajtjes së seancës kryesore ka nxjerrë aktgjykimin, C.nr.2251/2011 me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë thekson se Gjykata pasi vlerësoi provat e administruara e në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar. Nga faturat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet se paditësja i ka faturuar të paditurit në mënyrë të rregullt dhe se i padituri për këtë periudhë ka shpenzuar impulse të telefonisë fikse në shumën prej 151.93 €.Gjykata ka konstatuar se në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë provë materiale e dorëzuar nga i padituri me të cilën do të kundërshtohet borxhi ndaj paditëses. Si rezultat i kësaj, i padituri për shkak të mos pagesës së borxhit për shërbimet telefonike, ka ngelur në pozitën e debitorit ndërsa paditësi në pozitën e kreditorit. Sipas nenit 262 par. I të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, kreditori në marrëdhënien detyimore është i autorizuar që nga debitori të kërkojë përmbushjen e detyrimit, kurse debitori është i detyruar që ta përmbushë detyrimin me ndërgegje dhe në tërësi ashtu siç është përmbajtja e tij. Meqenëse në rastin konkret është vërtetuar se i padituri ka ngelë borxh ndaj paditësit, për periudhën kontestuese-borxhin e papaguar në shumën prej 151,93 €, për tel. fiks nr. 038-558457, gjykata ka zbatuar dispozitën e lartcekur në këtë gjendje të vërtetuar faktike dhe ka detyruar të paditurin që paditëses t'ia paguajë këtë borxh të papaguar. Vendimin për kamatëvonesën gjykata e ka bazuar në nenin 277 të LMD-së. Vendimin për shpenzimet e procedurës Gjykata e ka bazuar në dispozitën e nenit 449,1 dhe 452, I të Ligjit për Procedurën Kontestimore sipas së cilës paditësit

i pranohen shpenzimet për taksë gjyqësore për padi në shumë 15.00 € dhe për taksë për aktgjykim në shumë prej 15.00 € e gjithsej shuma prej 30.00 €.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuuese me ankesë.

I padituri në ankesën e parashtruar pretendon se borxhi me të cilin është ngarkuar hyn në faljen e borxheve publike duke u bazuar në Ligjin për Faljen e Borxheve Publike, kështu duke kërkuar që të lirohet nga detyrimi me të cilin është ngarkuar.

Gjykata e Apelit i vlerësoi pretendimet e mësipërme ankimore por gjeti se të njëjtat janë të pa bazuara. Është fakt se me Ligjin për Faljen e Borxheve Publike të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës është përcaktuar se falen borxhet publike për periudhën deri me 31 dhjetor 2008, e kjo është e përcaktuar me nenin 4 par.1 të Ligjit për Faljen e Borxheve publike ku parashihet se: *“1. Nga falja e borxheve publike për periudhën deri më 31 dhjetor 2008, sipas këtij ligji përfitojnë të gjithë personat të cilët kanë obligime të pashlyera ndaj Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike, me kusht që të njëjtit: 1.1. të kryejnë pagesën e plotë të obligimeve për periudhën nga 01 janar 2009 deri me 31 dhjetor 2014, atëherë personat e këtyllë, përveç faljes së tërësishme të borxhit për periudhën deri më 31 dhjetor 2008, do të përfitojnë edhe me faljen e gjobave, ndëshkimeve, interesit dhe çdo obligim tjetër që rrjedh nga mos pagesa me kohë e kryegjësë së borxhit për periudhën 01 janar 2009 deri me 31 dhjetor 2014, ose; 1.2. të lidhin marrëveshje me Institucionin Shtetëror apo Ndërmarrjen Publike për pagesën e borxheve me këste për periudhën 01 janar 2009 deri me 31 dhjetor 2014. Në rastin kur arrihet marrëveshja sipas nën-paragrafit 1.2 të këtij neni, atëherë personat e këtyllë, përveç faljes së tërësishme të borxhit për periudhën deri më 31 dhjetor 2008, do të përfitojnë edhe faljen e ndëshkimeve për periudhën 01 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2014”*.

Por që të vihet në zbatim neni i sipërcituar, pra ashtu që të konsiderohet se paditësi do të përfitonte nga falja e borxhit i njëjti është dashur që të lidhë marrëveshje me paditësen për pagesën e borxheve, e cila marrëveshje nuk është e lidhur në mes të palëve dhe si e tillë nuk gjendet në shkresat e lëndës, dhe si pasojë e kësaj as nuk mund të konsiderohet se i padituri gjen mbrojtje të drejtave të tij nga Ligji për Faljen e Borxheve Publike.

Paditësi po ashtu, pretendon se këtij aktgjykimi i mungon identiteti subjektiv pasi që në aktgjykim si i paditur detyrohet personi me emrin S. B., mirëpo, Gjykata e Apelit konsideron se ky pretendim është i pa bazuar për faktin se gabimi në emër trajtohet si një gabim teknik i cili nuk mund të ndikoj në një vendosje ndryshe.

Gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka detyruar të padituri S.B. që të paguaj detyrimin që e ka pasur ndaj paditëses dhe drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, e kështu ka zbatuar drejtë edhe të drejtën materiale. Neni 262 par.1 i LMD-së përcakton se: *“Kreditori në*

*raportin e obliguar është autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbush me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij*”. Duke pasur parasysh se i padituri nuk e ka përmbushur detyrimin e tij ndaj paditëses, duke pasur parasysh nenin e sipërcituar i njëjti ka pasur për detyrim që ta përmbush borxhin, andaj, Gjykata e Apelit e përkrah vendimin e gjykatës së shkallës së parë duke e konsideruar si të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1474/18, me datë 04.08.2021

Kryetari i kolegjit, Gjyqtari  
Faton Ademi